



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
 SUDSKI SAVET KOSOVA
 KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË / OSNOVNI SUD U MITROVICI / BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr.170/2008

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Skender Shala, ne çeshtjen juridike te paditesve I dhe qe te gjithë nga fsh. Zhabar I Ulet, Komuna e Mitrovices, te cilet i perfaqeson Avokati nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurve dhe nga fsh. Zhabar I Eperm, Komuna e Mitrovices, per vertetim pronesie, vlera e kontestit 1.250,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.15.01.2013, bie kete:

A K T G J Y K I M

I – APROVOHET, Kerkespadia e paditesve dhe **VERTETOHET** se paditesit dhe qe te gjithë nga fsh. Zhabar I Ulet, Komuna e Mitrovices, si trashëgimtar te tani te ndjerit, ishe nga fsh. Komuna e Mitrovices, ne baze te marrveshjes gojore mbi shiteblerjen e paluajtshmerise te vitit 1990, dhe ne baze te mbajtjes me mirebesim dhe te pandërprere mbi 20 vite, jane pronar me nga 1/3 te pjeses se ngastres katastrale nr.285/1, me kultur Are, klasa e 6, ne vendin e quajtur, Selishte”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes ne siperfaqe prej S=7020 m2, pjeses se ngastres katastrale nr. 285/2, me kultur Pemishte, klases se 3, ne vendin e quajtur “Selishte”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej S=342m2, pjeses se ngastres katastrale nr. 284/0, me kultur Kullose, klases se 2, ne vendin e quajtur “Selishte Lama”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej S=561m2, pjeses se ngastres katastrale nr. 287/0, me kultur Kullose, klases se 2, ne vendin e quajtur “Selishte te Prroni”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej S=683m2 dhe pjeses se ngastres katastrale nr. 288/0, me kultur Mal, klases se 3, ne vendin e quajtur “Selishte te Prroni”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej S=1457m2, sipas çertifikatave te pronesise me nr. te lendes 12-1466 dhe nr. 12-1465, ZK Mitrovica e qe evidentohet ne emer te vellezerve te te paditurve dhe

II – OBLIGOHEN te paditurit qe te drejte paditesve dhe t'i lejojne qe paditesit kete paluajtshmeri ta regjistrojne ne menyre te lejte, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komunale ne Mitrovica, ne afatin prej (pesëmbëdhjetë) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercehim te permbarimit te shpallur.



- Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesit ne padin e tyre te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se babai i tyre ne vitin 1990, sipas kontrates gojore me shitsit tani te paditurit dhe me çmim prej 30.000.DM, e kane blere paluajtshmerine e cekur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi dhe qe nga momenti I shitblerjes ka hyre ne shfrytzim dhe posedim te kesaj paluajtshmerije duke mosqene I penguar nga askush e edhe sot e shfrytzoj pa kurfar pengese.

Paditesit ne baze te shiteblerjes dhe mbajtjes e kane fituar te drejten e prones per kete paluajtshmeri, andaj kane interes juridik qe te vertetohet se ata jane pronar te pjeseve te ketyre ngastrave te cekura si ne dispozitiv.

I autorizuari i paditesve ne seancen e shqyrtimit kryesore dhe ne fjalen perfundimtare deklaroi se mbetet ne tersi prane padise dhe kerkespadise dhe precizimit te saj duke i propozuar gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise se paditesve ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Te paditurit ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesve njezerit deklaruan se nuk e kontestojne kerkespadine, nuke e kundershuan nxjerrjen e provave dhe kerkuan qe gjykata vendimin ta nxjerre ne baze te rezultatit te provave duke shtuar se kjo shitblerje eshte bere me vullnetin e tyre.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk I kerkuan.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: çertifikatat e pronesise me nr. Te lendes 12-1465 dhe nr. 12-1466, ZK Mitrovica ted t. 24.12.2012, ne emer te vellezerve te ndjere te te paditurve, dhe lexoj ekspertizen gjeodete ne emer te ekspertit gjeodet Ruzhdi Ujkani, te dt.26.11.2012, beri veshtrim ne skicen e terrenit, procesverbalin mbivendeshiqimin te kesaj gjykate C.nr. 170/2008 te dt. 07.11.2012, ndegjoi deshmitarct Mon Bahtiri dhe Bahtir Bahtiri dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga Çertifikatat mbi pronesine te cekura me lart, konstatohet se pjeset e parcelave katastrale nr.285/1, 285/2, 284/0, 287/0 dhe 288/0, evidentohen ne emer te vellezerve te te paditurve tani te ndjeret dhe

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera ne pjeset e parcelave kontestuese nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjcodezise dhe Kadastrit ne Mitrovica, ka vertetuar se pjeset e paluajtshmerine kontestuese bien- gjegjesisht e perbejne pjeset e parcelave te cekura me larte me masat dhe kufijt te shprehura si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe skicen e terrenit, e cila eshte pjese perberese e kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.



Nga procesverbali mbi vendeshiqimin I kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejte ne vende konstaton se paluajtshmerit kontestuese jane te perkufizuar me gardhe me huje te drurit ne to nuk ka objekte te ndertuara dhe sipas deklarates se eksperitit gjeodet ne vende te ngjarjes te njejtat kufizohen me prona private.

Deshmitari :
deklaroj se ai personalisht e din se babai I ndjer I paditesve i ka blere paluajtshmerite nga tani te paditurit Shaban dhe Pajazit Sadiku ne vitin 1990, ne siperfaqe rreth 1 hektar e 30 ari, me çmim te shitblerjes prej 30.000 DM, per tere paluajtshmerite te cilin çmim I njejtë e ka paguar ne tersi. E di se shitblerja eshte bere ne baze te marreveshjes gojore, sepse une kam qene personalishte aty present , paditesit nuk kane ndertuar kurfar objekti ne ate paluajtshmeri por e kane shfrytezuar vetem si kullose , dhe e di se paditesit prej vitit 1990 kure e kane blere kete paluajtshmeri e kane shfrytezuar pa pengesa nga askush. Keto rrethana me jane te njohura nga se kam qene dhe jane fqj I shitesve dhe bleresit tani paditesve.

Deshmitari :
Jeklaroj se ai personalisht e dine se babai I ndjer I paditesve e ka blere kete paluajtshmeri qyshe ne vitin 1990, nga tani te paditurit , kjo paluajtshmeri eshte dikun ne siperfaqe prej rreth 1 hektar e 50 ari, me çmim te shitblerjes prej 30.000 DM, per tere paluajtshmerite te cilin çmim ai e ka paguar ne tersi. E di se shitblerja eshte bere ne baze te marreveshjes gojore, e di se paditesit pase blerjes se asaj paluajtshmerije nuk kane ndertuar kurfar objekti, por te njejten e kane shfrytesuar per kullos. Dhe e di se prej momentit te shiteblerjes paditesit nuke kane pasur kurfar pengesash nga askush ne shfrytezimin e kesaj paluajtshmerije. Keto rrethana me jane te njohura nga se une jetoj ne fqinesi me te paditurit dhe prej momentit te shiteblerjes edhe me paditesit sepse une kam toke ne kufi me tani paditesit .

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se patundshmerit tani lendore kontestuese i ka blere babai i paditesve, ne baze te marreveshjes gojore mbi shitblerjen ne vitin 1990, me emim te shitblerjes prej 30.000 DM, per tere paluajtshmerit, te cilin çmim ne tersi u'a ka paguar shitesve tani te paditurve dhe ' , te cilet menjeher u'a kan lene ne disponim dhe shrytezim te lire kete paluajtshmeri bleresit, babait te paditesve - tani paditesve te cilet, e kane shfrytezuar kete paluajtshmeri pa pengesa qe nga momenti i shitberjes e gjere me tani.

Ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat e tjera sendore, eshte percaktuar se: Personi i cili me mirebesim e ka 20 (njetzet) vjet ne posedim te panderprere nje paluajtshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, paditesit e kane pasur ne shfrytezim dhe disponim te lire keto paluajtshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne unen e paditesve ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e drejtes se prones ne baze te mbajtjes e keto jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i kesaj paluajtshmerive.

Mbajtja me mirebesim ekziston nga se babai I ndjer I paditesve kete paluajtshmeri e ka blere nga shitesit tani te paditurit Pajazit dhe Shaban Sadiku.

Koha e nevojshme mbi 20 (njetzet) vite ekziston sepse paditesit - babai i tyre e ka blere kete paluajtshmeri nga te paditurit, qysh nga vitet 1990.



Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesit kane hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te kesaj paluajtshmerie te tyre, gjere me tani.

Prandaj, gjykata konkludon, se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise te ketyre paluajtshmerive nga ana e paditesve me mbajtje, konform nenit 40 te Ligjit per Pronesin dhe te Drejtat te Tjera Sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazohet konform nenit 450 dhe 459 te LPK-es.

Nga arsyet e cekura me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.170/2008, dt.15.01.2013.

Gjyqtari,
Skender Shala

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesin e pershkrimt e verteton:

